



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- **Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK)
 - **Nga:** Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Republikës së Kosovës (DHPGJS)
 - **Datë:** 17 janar 2023
 - **Lënda:** RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUdhËN
01 janar – 31 dhjetor 2022
-

Në DHPGJS gjatë vitit 2022 kanë qenë të angazhuar 13 gjyqtarë në zgjidhjen e lëndëve, 10 prej tyre në shkallën e parë dhe 3 në shkallën e dytë, gjegjësisht në Kolegjin e Apelit.


Lëndët në punë gjatë vitit

Gjithsej në dy shkallët gjyqësore në fillim të vitit janë trashëguar nga viti paraprak 15665 lëndë, janë pranuar edhe 1773 lëndë të reja, kështu gjatë vitit në punë kanë qenë 17438 lëndë. Prej tyre janë zgjidhur 2921 lëndë, kurse kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 14715 lëndë në dy shkallët gjyqësore.

Në shkallën e parë gjyqësore nga 15695 lëndë sa kanë qenë në punë janë zgjidhur 2196 lëndë, kurse kanë mbetur të pa zgjidhura 13499 lëndë në fund të vitit.

Në shkallën e dytë gjyqësore nga 1743 lëndë sa kanë qenë në punë janë zgjidhur 725 lëndë, kurse kanë mbetur të pa zgjidhura 1018 lëndë në fund të vitit.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur lëndët e trashëguara (paraprake) në fillim vitit, lëndët e reja të pranuar, lëndët në punë, lëndët e kryera dhe lëndët e mbetura të pakryera në fund vitit.



Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve në raport me lëndët e reja të pranuar gjatë vitit

Shkalla e efikasitetit të lëndëve të kryera në raport me lëndët e reja të pranuar gjatë vitit është 164.75 %, ngase janë kryer 2921 lëndë ndërsa janë pranuar 1773 lëndë të reja.



Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me vitin paraprak (2021) kemi rënje të numrit të lëndëve të kryera dhe të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve në raportin lëndët e kryera dhe lëndët e reja të pranuar gjatë vitit.

Në vitin paraprak janë kryer 3343 lëndë kurse shkalla e efikasitetit ka qenë 203.35% kurse në këtë vitë janë kryer 2921 lëndë dhe shkalla e efikasitetit është 164.75%.


Faktorët që kanë ndikuar në numrin e lëndëve të kryera dhe efikasitetit janë:

Dy gjyqtarë janë pensionuar, një gjyqtare ka shkuar në pushim pa pagesë, një bashkëpunëtor është emëruar gjyqtar dhe një bashkëpunëtores ka shkuar në pushim të lehonisë. Por edhe numri i lëndëve të reja të pranuar në këtë vitë është më i lartë se në vitin paraprak, në vitin paraprak kanë qenë të pranuar 1644 lëndë të reja kurse në këtë vitë janë pranuar 1773 lëndë të reja. Gjithashtu edhe zhvendosja e zyrave nga kati i IV i Objektivit A në Objektivin E dhe në katin 0 të Objektivit A gjithashtu ka ndikuar në punën e gjykatës.

Lëndët e zgjidhura sipas natyrës ligjore gjatë vitit


Në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë vitit që përfshijnë:

- 687 lëndë - AC - I, Ankesat e kundër vendimeve të Dhomës
- 38 lëndë - AC - II, Ankesat Kundër vendimeve të gjykatave tjera
- 3 lëndë - C - I, Paditë e Privatizimit
- 30 lëndë - C – II dhe SCEL, Listat e Punëtorëve
- 144 lëndë - C – III dhe SCC, Paditë Pronësore
- 2019 lëndë - C – IV dhe SCL, Paditë e Likuidimit



Publikimi i vendimeve gjatë vitit

Gjatë vitit është vazhduar me publikimin e vendimeve të Gjykatës, kështu që janë publikuar në Web faqe gjithsej 2044 vendime të Dhomës. Prej tyre 1502 vendime janë të shkallës së parë gjyqësore kurse 542 janë të shkallës së dytë.



Regjistrimi i lëndëve në SMIL

Gjatë këtij viti gjegjësisht nga muaji maj është filluar me regjistrimin e lëndëve në SMIL. Fillimisht janë regjistruar vetëm lëndët e reja kurse nga fundi i muajit tetor është filluar edhe me regjistrimin e lëndëve të vjetra. Deri në fund të këtij tre mujori janë regjistruar 4709 lëndë.

Identifikimi i problemeve dhe propozimi për zgjidhjen e tyre

Problem i vazhdueshëm në DHPGJS është numri i pamjaftueshëm i stafit gjyqësor dhe atij administrativ. Duke patër parasysh numrin e madh të lëndëve dhe numrin e stafit aktual, është shumë e vështirë dhe e pa mundur të zgjidhen lëndët e grumbulluara në një afat të arsyeshëm. Kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje mundësin e shtimit të numrit të stafit gjyqësor dhe atij administrativ në DHPGJS.

Si problem gjatë vitit ka qenë edhe zhvendosja e gjykatës nga Kati i IV i Objektit A në Objektin E dhe në një pjesë të Katit 0 të Objektit A. Me shumë vështirësi është bërë akomodimi në hapësirat e reja ngase numri i zyrave ka qenë më i vogël në krahasim me numrin e zyrave të më parme. Kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje problemin me hapësirat punuese për nevojat e DHPGJS.